

SUBJEKTI "INERTOBETON" sh.p.k.

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË
NDIKIMIT NË MJEDIS
GURORE + LINJË PRODHIMI INERTESH
PËRROI I LLAKOTRICËS
KOMUNA LUKOVË
QARKU VLORË**



MARS 2015

TË DHËNAT PËR SUBJEKTIN

Të dhënat për kompaninë **"Inertobeton" sh.p.k.** me administratorë **z. Skënder Muço**, janë marrë nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregëtar për subjektet Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, dhe në formë të përmbledhur janë si më poshtë :

- Numuri Unik i Identifikimit të Subjektit (NIPT)	J64228817E
- Data e regjistrimit	01.07.1996
- Emërtimi i subjektit	INERTOBETON
- Forma ligjore	shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
- Data e themelimit	10.09.1993
- Selia	Përroi I Llakotricës, rruga Eremec, Komuna Lukovë, Qarku Vlorë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë : Prodhimi I fraksioneve të ndryshme të materialeve inerte , betone të markave të ndryshme si dhe tregëtimi I tyre ,montim banesash , ndërtim rrugësh dhe veprash industriale etj.....

Te dhenat baze

SIPËRFAQJA TOTALE E SHFRYTËZIMIT:	18,2 ha
NGA KËTO:	
• SIPËRFAQJA E GURORES	18,0 ha
• TERRITORI I LINJËS SË PRODHIMIT TË INERTEVE	0,2 ha
KAPACITETI I PRODHIMIT VJETOR	72 000 m3/vit

Foto 1: Pamje satelitore e vendndodhjes së sheshit të gurores dhe linjës së inerteve



Përmbledhje e bazës ligjore për menaxhimin e mjedisit

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Ndër më specifikët po përmendim:

BAZA LIGJORE	
Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011	"Për mbrojtjen e mjedisit"
Ligji nr.10 448, datë 14.7.2011	"Për lejet e mjedisit"
Ligji nr.10 440, datë 07.7.2011	"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011	"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
Ligji nr. 9115 datë 24.07.2003	"Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
Ligji nr. 10 304 datë 15.07.2010	"Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë"
Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009	për "Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	"Për mbrojtjen e biodiversitetit".
Ligji Nr.8906, datë 06.06.2002 , ndryshuar me ligjin Nr. 9868, date 04.02.2008	"Për zonat e mbrojtura"
Ligji nr. 93 85 datë 04.02.2005 ndryshuar me ligjin nr 9791 datë 23.07.2007, ndryshuar me ligjin nr. 36/2013	"Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
Ligji nr. 9334 datë 16.12.2004	"Për aderimin e Shqipërisë në Protokollin e Kiotos, në Konventën për Ndryshimet Klimatike"
Ligji nr. 9774 datë 12.07.2007	"Për administrimin e zhurmës"
Ligji nr. 8766 datë 05.04.2001	"Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin"
Ligji nr. 8756 datë 26.03..2001	"Për emergjencat civile"
VKM nr. 13 datë 13.01.2013	"për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe afateve për zhvillimin e procedurave të VNM"
VKM nr. 479 datë 29.06.2011	"Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë"
VKM nr. 435 datë 12.09.2002	"Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
VKM nr.177 datë 31.03.2005	"Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe"

	kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse"
VKM nr. 804 datë 04.12.2003	"Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihet në mbrojtje
Udhëzim nr. 8 datë 27.11.2007	"Për nivelin kufi të zhurmave në mjedisë të caktuara"
Udhëzim nr. 3 datë 17.05.2006	"Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret
Udhëzim nr. 383 datë 20.05.2011	"Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të veprimtarive për mbylljen e një veprimtarie minerare
Akt. Nr. 302 datë 12.04.2011	"Për miratimin e parimeve bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare , të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare dhe të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare"

Legjislacioni Ndërkombëtar

Shqipëria është nënshkruese e një numri të madh konventash dhe marrëveshjesh mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikat ndërkombëtare.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, duhet që kuadri ligjor shqiptar të përshtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel rajonal dhe ato të BE-së dhe më poshtë ilustrohen në mënyrë të përmbledhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit, nëpërmjet një kuadri të përmbledhur të qëllimeve kryesore të programeve komunitare dhe direktivave kryesore që rrjedhin nga një sektor i tillë.

Raporti i VNM-së për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqë pjesë të tij me legjislacionin e BE-së mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm.

Disa nga Konventat dhe Protokollet e ratifikuara nga Shteti Shqiptarë :

- Protokoll i Kievit, "Për vlerësimin strategjik mjedisor". Ratifikuar në vitin 2005
- Protokoll i Kartagjenës "Për biosigurinë", bërë palë në vitin 2005
- Konventa e Stockholmit "Mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm"
- Protokoll i Kartagjenës "Për sigurinë biologjike", Ratifikuar në vitin 2004.
- Konventa e Washingtonit "Për tregëtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së eger"

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E ZONIMIT TË PROJEKTIT

Qëllimi i këtij aktiviteti: Aktiviteti ka për qëllim shfrytëzimin e karrierës për prodhim të gurit gëlqeror dhe prodhimin e inerteve nga fraksionimi i gurit gëlqeror i cili është një element shumë i rëndësishëm në fushën e ndërtimit. Me metodat dhe kriteret inxhinierike të aktivitetit do të njihemi në kapitullin e përshkrimit të veprimtarisë.

Qëllimi i VNM-se: Të sigurojë vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) është një studim i cili ka për qëllim përcaktimin e impakteve mjedisore që do të ketë projekti në mjedisin tokë, ujë, ajër dhe synon parashikimin e të gjitha efekteve të pritshme në mjedis.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara

Raporti i VNM-së siguron që ndikimet mjedisore të rëndësishme janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë në mënyrë të kënaqëshme në planifikim, projektim dhe zbatim të projektit.

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
- Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
- Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Studimi përcakton detyrat dhe mjetet e nevojshme për arritjen e misionit dhe objektivave në jetën e komunitetit.

Gjithashtu një synim tjetër është të përcaktojë e rekomandojë masat teknike-organizative për zbutjen e anëve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Me qëllim që të minimizohen ndikimet e pafavorshme afat-shkurtër dhe afat-gjatë mbi mjedisin.

TË DHËNA PËR MJEDISIN EKZISTUES TË ZONËS KU ZBATOHET PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ

BURIMET FIZIKE

Pejsazhi natyror

Komuna Lukovë, e përbërë prej 9 fshatrash, shtrihet thuasht tërësisht në bregdetin e Jonit në një gjatësi prej 35 kilometrash, ku në të derdhen ujrat e lumit te Borshit dhe te Bunecit dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 150 000 ha.

Terreni kryesisht kodrinor i territorit ka favorizuar frutikulturën dhe veçanërisht kultivimin e ullirit. Komuna ka një popullsi prej rreth 10 000 banorësh që krahas turizmit llogarisin ndër aktivitetet e rëndësishme ekonomike përpunimin e ullirit, ndërtimtarinë, etj

Banorët janë të vendosur në fshatrat Lukovë, Borsh, Ftterrë, Çorraj, Piqeras, Sasaj, Qazim Pali, Shën Vasil dhe Nivicë.

Komuna Lukovë shtrihet në jugperëndim te Republikës së Shqipërisë. Ajo kufizohet nga veriu me bashkinë Himarë, lindja me Komunën Vergo, Jugu me bashkinë Sarandë dhe nga perëndimi laget nga ujërat e detit Jon. Qendra administrative e saj është Lukova. Pikat kryesore të hyrjes në Komunën Lukovë janë rruget nacionale Vlorë-Sarandë, Vlorë-Kuç-Ftterrë dhe porti detar i Bunecit.

Meqënëse aktiviteti i kompanisë "Inerto beton" sh.p.k., është i vendosur në kufirin që ndanë Komunën Lukovë me Bashkinë Sarandë dhe konkretisht qytetin e Sarandës, po ju referohemi të dhënave të këtij qyteti, pasi para vitit 2010 ky territor ishte pjesë e qytetit të Sarandës.

Qyteti i Sarandës , është qyteti që shtrihet në Jug –Jugperëndim të vendit tonë . Shtrihet në një terren paramalor, midis detit Jon në perëndim dhe terreneve malore të Malit të Sarandës në lindje. Teritori është mjaft mirë i ekspozuar ndaj diellit dhe detit , është i ndriçuar gjatë gjithë ditës . Deti përbën figurën kryesore të qytetit .

Veçoritë klimaterike që shfaq kjo zonë janë të përshtatshme e të shfrytëzueshme për trajtimin e objekteve me karakter banimi dhe shërbimi.

Gjiri i Sarandës, është një nga më të mëdhenjtë e bregdetit Jon , i cili ka formën e një harku e futet në tokë rreth 1 km. Brigjet janë shkëmbore dhe të larta . Pjerësia e shpatit të kodrave të Gormartit (167.8m) dhe të Berdeneshit (103 m) është mesatare . Në jug të qytetit , shtrihet faqja perëndimore e malit të Lëkurësit . Në perëndim shtrihet veriu i ishullit të Korfuzit , ngushtica e tij me drejtimin V-VP e J - JL. Është e gjatë 34 milje. Pika më e ngushtë rreth 3 milje . Thellësia e kanalit lëkundet rreth 55 -70m.

Midis kepit të Paladhës dhe kepit të Varesë në VP, formohet gjiri i Limjonit me gjerësi hyrje rreth 185 m . Mbi këtë sektor ngrihet nje vargmal (me dy maja , ajo e Oftës 507 m dhe e Lasarës 585 m lartësi) i cili zbret me pjerrësi mesatare në bregdet . Qyteti i Sarandës zë një sipërfaqe 2147 ha, dhe ka rreth 41.000 banorë. Laget në një gjatësi të vijës së ujit nga deti Jon 7.5 km, ndërsa kufijtë e tjerë janë të përcaktuar si bashkësi elementesh gjeografik-natyrore e social ekonomik .Rrallë në ndonjë rajon gjenden bregdeti, fushgropa , kodra , lugina , mali , mikro e makroforma interesante të tipit të monumenteve natyrore. Pozita gjeografike ofron edhe disa elementë bioklimatike optimalë e deri specifik .

Klima

Zona ku shtrihet projekti ka një klimë tipike Mesdhetare. Karakteristikë themelore e kësaj lloj klime është dimri i butë e i lagët dhe vera e nxehtë dhe e thatë. Klima është e butë dhe ofron mundësi të mira për një sezon turistik relativisht të gjatë. Për të pasur një pamje më të qartë mbi kushtet klimatike të kësaj zone, më poshtë po shqyrtojmë disa nga elementët kryesorë të klimës:

1.1.1.Erërat:

Shpejtësia mesatare: nga 1.8 m/sek – deri 2.2 m/sek

Shpejtësia minimale: nga 1.4 m/sek – deri 1.6 m/sek

Shpejtësia maksimale: nga 2.2 m/sek – deri 2.4 m/sek

Lagështia e ajrit

Lidhet ngushtë me temperaturën e ajrit. Relativisht lagështia mujore varion nga 62% deri 69%, ndërsa lagështia relative vjetore është 66%. Zgjatja e diellzimit në të arrin 2500 orë në vit, ndërsa numri i ditëve me diell është rreth 330.

Temperatura mesatare vjetore

Në zonën e studimit është midis 16.1 - 17.7°C. Në janar temperatura e ajrit është midis 8-10°C, kurse në gusht luhartet midis 24-26° C. Sezoni i plazhit përgjatë bregdetit jugor të Shqipërisë luhartet midis 150 – 180 ditëve (bazuar në numrin e ditëve me temperaturë mbi 20°C).

Gjithashtu zona në studim është shumë homogjene për sa i përket shpërndarjes së rreshjeve. Periudha me më shumë rreshje është gjysma e ftohtë e vitit. Gjatë kësaj periudhe, në të gjitha sipërfaqet, mesatarisht bie në dimër 70% e rreshjeve vjetore dhe në periudhën e verës 30%. Në sipërfaqen në studim, numri i ditëve me rreshje shkon mesatarisht nga 30 deri në 50 ditë

TË DHËNAT GJEOLOGJIKE TË ZONËS SË PROJEKTIT

Ndërtimi gjeomorfologjik i zonës është i kushtëzuar dhe nga ndërtimi gjeologjik i saj. Formacionet gjeologjike me historinë e zhvillimit të saj ka qënë themeli i ndërtimit gjeomorfologjik, duke marrë parasysh dhe proceset ekzogjene në konfigurimin e saj.

Shtrirjen hapsinore të qytetit dhe rreth tij mund ta ndajmë në tre njësi bazë:

Njësia fushore, njësia kodrinore dhe njësia paramalore.

- Njësia fushore përfaqëson një pjesë të fushës së Vrionit , aty ku është hyrja për në territorin e Bashkisë Sarandë .Nga ana gjeologjike përfaqësohet nga

depozitimet flishoidale dhe tokat e bukës. Në këtë zonë kemi të bëjmë me depozitime liqenore dhe prurje të lumit të Kalasës, ku kjo e fundit ka luajtur rol kryesor në peneplizimin e zonës.

- Njësia kodrinore të përfaqësuar nga depozitimet flishore dhe kap nga Ura e Gajdarit deri tek kryqëzimi i rrugës së Bregdetit. Kjo njësi kodrinore ka shtrirje veriperëndimore dhe kuotë nga niveli i detit 80 – 100 m. Në përgjithësi është pak e aksidentuar me kurizore të rrumbullakosura dhe shpate të regullta me ondulime të ëmbla. Në përgjithësi këto kodra janë të zëna me ndërtime dhe parcela me ullishte dhe drurë të tjerë frutor.
- Njësia paramalore përfaqësohet nga depozitimet karbonatike dhe përfshin hapsiren nga kryqëzimi ku ndan rruga e Bregdetit dhe tërë sipërfaqen ku shtrihet qyteti i Sarandës dhe fshati Gjashtë . Edhe kjo njësi ka shtrirje veriperëndimore me lartësi nga niveli i detit 200 – 500 m, kurse qafat ndarëse mbi 150 m mbi nivelin e detit.

Këto zona në përgjithësi paraqiten të çveshura duke shërbyer si kullota, si dhe për trualle, ku shtrihet dhe qyteti i Sarandës. Qyteti i Sarandës ndodhet në pjesën J-JP të Shqipërisë. Ai shtrihet në pjesën VP-P të ultësirës së fushe gropes së Delvines .

TREGUESIT PEDOLOGJIKË

Nga analizat pedologjike të profileve të hapura në parcelat e lira vërehet se janë toka gurishtore , shkëmbore të kuqërremta, jokarbonatike skeletike (nuk shkrumbojnë me HCl)

Shtresat e profilit janë pak të dallueshme me horizont humusor që mungon.

Të dhënat e analizave tregojnë se janë të pasura me **Fosfor** dhe **Potas**. Reaksioni uxor lëviz nga 6,6 – 7.

HIDROLOGJIA, KUSHTET HIDROGRAFIKE TE RAJONIT

Rajoni paraqitet me një regjim hidrodinamik të zhvilluar dhe karakterizohet nga burime natyrore që dalin e derdhen në sipërfaqe. Studimi në kompleks i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore është me efektiv duke i studjuar ato në kompleksitetin e faktoreve gjeologjik dhe hidrogjeologjik duke percaktuar origjinën dhe levizjen hidrodinamike të tyre.

Në rajon janë evidentuar dy komplekse ujëmbajtës të rëndësishëm

- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve karbonatike (T-J-Cr –Pg1-2) .
- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve Kuarternare (Q).

Kompleksi karbonatik është më i rëndësishëm, me të cilat lidhen një numër i konsiderueshëm burimesh ujore të cilat kanë debite relativisht të mbedhura e të qëndrueshme ku mbizoterojnë burimet ujore të karbonateve, të cilat përveç burimeve sipërfaqësore, janë takuar edhe gjatë shpimit e përvehtësimit në disa puse të hapur në rajon nga komuniteti i zonës.

Nga ana strukturore, pellgu ujor i depozitimeve kuarternare shtrihet kryesisht në gjithë sipërfaqen e fushgropes së Delvines . Trashësia e depozitimeve të Kuarternarit nga 0 metra pranë rrezës së terreneve malore arrin 80-100 m pranë fshatit Vrion dhe në lindje të Cukes .

Kushtet hidrogjeologjike që kondicionojnë lidhjen e burimeve sipërfaqësore me ujrat e objekteve nëntokësore.

Duke u bazuar mbi ndërtimin gjeologjik të rajonit të Sarandës , në përgjithësi të krijohet bindja dhe përfytyrimi se kushtet hidrogjeologjike të njësive të caktuara tektonike dhe strukturore janë të kushtëzuara dhe janë në vartësi të disa parametrave hidrogjeologjike dhe tektonike e litofacial si me poshtë :

- *Forma e gjendjes së ujërave nëntokësore e natyrore në basenet ujore, komplekset që ndërtojnë ato dhe përfaqesimi litologo-facial i tyre.*
- *Veçimi i objekteve ose i horizonteve ujore.*

- *Roli i tektonikës ose i sistemeve të çarieve apo i fenomeneve të karstit.*
- *Vetitë kolektorale; poroziteti, përshkueshmëria dhe aftësitë filtruese në objektet ujore.*

Bazuar në ndërtimin gjeologjik e tektonik të rajonit veçojmë basenin ujor të strukturave karbonatike që formojnë vargje malore në lindje e verilindje të fushëgropës së Delvinës .Në këtë basen marin pjesë depozitimet e kompleksit karbonatik, dhe depozitimet e reja të Kuaternarit. Këto të fundit formojnë pellgun ujëmbajtës të ultësirës me depozitime Kuaternare me trashësi të konsiderueshme .

Nga analiza e vetive kolektorale porozitetit dhe përshkueshmërisë së shkëmbinjëve që ndërtojnë basenet ujore veçojmë 2 tipe kryesore shkëmbinjsh kolektoral:

OBJEKTI UJOR KARBONATIK (T3 - Pg2)

Në këtë objekt ujëmbajtës, përfshihen ujrat gëlqerore të Triasikut të sipërm dhe deri në Eocen . Depozitimet e këtij objekti ndërtojnë pjesën e sipërme të kompleksit karbonatik dhe ekspozohen në sipërfaqe në të gjitha strukturat antiklinale të vargjeve e strukturave antiklinale.

Këto ujra me anë të rrjetit të dendur të çarjeve, përcillen për në thellësi, duke u grumbulluar kështu në kolektorët dhe rezervuarin ujëmbajtës nëntokësore. Ky kompleks Karbonatik shtrihet në pjesët lindore të rajonit në studim, fushëgropës së Delvinës .

KOMPLEKSI UJËMBAJTËS I KUATERNARIT

Ujërat e këtij kompleksi takohen në depozitimet aluviale dhe proluviale, te cilat marrin pjese ne formimin e ultësirës. Ky kompleks ujor, në studimet e kryera, inkludohet në shkëmbinjet jo kompakt, të shkrifet.

Ujëmbajtja e këtij pellgu ujorë në depozitimet e kuaternarit është konstatuar me puset e hapura pranë Vrionit dhe në hapësirën në juglindje të Çukës.

FLORA DHE VEGJETACIONI EKZISTUES

Bregdeti mesdhetar dhe mjedisi shkëmbor kanë shkaktuar zvogëlim apo varfërimin e përberjes floristike, duke e bërë atë një bimësi karakteristike të habitateve hasmo-halofilike, vecanërisht në nivele nga 0-40 m mbi nivelin e detit.

Llojet dominante janë **Limonium anfractus**, **Crithmin sp.**

Kjo bimësi është e përzier ndërthurur me habitatin tjetër "shkureta termo-Mesdhetare". Këto përfaqësohen nga *Quercetea. ilicis*, *Phlomis fruticosa*, *Urginea maritima*, *Pistacia lentiscus*, *Pyrus*, *Amigdaliformis*, *Quercus coccifera*, *Palurus spinachristi*, *Brachi podium sp*, *malcolmia maritima*, *Asparagus*, *Saponaria*, *Colutea arboreshens*, *Juniperus comunis*, *Laurus nobilis*, *Spartum junceun*, *Phyllyrea media* etj. Në tokat me shtresë të madhe humusi, në zonat më pak të ekspozuar ndaj diellit këto lloje paraqiten më mirë nga gjendja ekologjike.

Variacionet e shumta ekologjike janë dhe rrjedhojë e aktivitetit antropogjen. Djegia e malit të Sarandës nga blegtorët dhe pakujdesia, ka ndihmuar në prishjen e ekujlibrave, shkatërimin e dheut, erozionin dhe për rrjedhojë dhe në zhdukjen e bimësisë, duke cënuar kështu ekujlibrin natyror të vendosur gjatë mijëra viteve. Gjithë kjo bimësi përfaqëson stadin e parë të dërgimit të ilqes (*Quercusilet*) në formacione shkëmbore gëlqerore dhe në vendet e ekspozuara ndaj dritës së diellit. Këto komunitete në përgjithësi janë të përfaqësuara nga shkurreta gjithnjë të gjelbërta. Është një bimësi karakteristike që haset vetëm në brigjet joniane në shpatet shkëmbore 40-200 m mbi nivelin e detit.

Laurus nobilis, *Quercus ilex*, *Salvia officinalis*, *Origanum vulgare*, *Hypericum perforatum* futen në lloje të kërcënuara seriozisht. Këto habitate vështirë ta marrin veten.

SHTRIRJA DHE TË DHËNAT GJEOGRAFIKE

Qyteti i Sarandës është qendra e njësisë vendore me të njëjtin emër. Ai ndodhet në pjesën më jugore të vendit dhe shtrihet në shpatin e tre kodrave përgjatë bregdetit, në gjirin me të njëjtin emër të Detit Jon. Shtrihet midis Kepit të Dentës, në jug dhe Kepit të Paladhesë në veri - përfundim në një gjatesi 7.5 km e gjerësi maksimale 1

km. Eshte një gji përgjithësisht i thellë, i pastër me një ngjyrë karakteristike, blu e thellë, me breg të lartë e shkëmbor.

Qyteti shtrihet :

- Në gjatësinë lindore 20° 00' 03''
- Në gjatësi veriore 39° 52' 20''

Qyteti i Sarandës shtrihet në një sipërfaqe prej 800 ha, përgjatë një vije bregdetare 7.5 km, buzë detit Jon dhe rreth 1 km në thellësi, në shpatet e tre kodrave në veri.

CILESIA E AJRIT

Monitorimi rregullisht i Cilësisë së ajrit është relativisht fenomen i ri në Shqipëri që është bërë kohët e fundit nga Instituti i Shëndetit Publik. Tregues kryesor janë SO₂, Nox, përqendrimi i ozonit në troposferë dhe grimcat me diametër <10mikron (P M₁₀).

Cilësia e ajrit në zonë është e pastër pa erëra, pa tymra pasi në këtë zonë nuk kemi ndonjë aktivitet industrial. Klima është ajo tipike mesdhetare e zonës fushore të ultesirës mesdhetare bregdetare të Shqipërisë

CILESIA E UJIT

Monitorimi i Ujit të pijshëm realizohet nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe Drejtorite Rajonale perkatese ne rrethe. Jane monitoruar rreth 15 parametra fizike dhe kimike të ujit të pijshëm.

ARKEOLOGJIA

Arkeologjia tokësore përfshin shumë rrënoja dhe pika interesante të qytetit të Sarandës dhe rrethinat e tij. Pikat historike ruhen dhe mbrohen. Edhe në afërsi të investimit që do të zhvillohet ndodhen rrënojat e Manastirit të Dyzet Shënjtoreve, nga ku ka marrë edhe emrin qyteti i Sarandës si dhe pjesë nga muri rrethues i qytetit të vjetër, por ky investim nuk ka impakte negative në këto zona historike.

Gjithashtu në territorin e Komunës Lukovë , që kanë afërsi me objektin , janë tre objekte kulti , një objekt i fesë bektashiane , në afërsi të aktivitetit , i ndërtuar rishtas nga ky komunitet dhe dy objekte kulti të fesë ortodokse , që janë Manastiri i Kakomesë dhe Manastiri i Krorëzës, por ato nuk janë të ndikuara nga aktiviteti që kryen subjekti. Të dy manastiret janë objekte të shekullit 16 – 17 dhe ndodhen rreth 6 – 7 km larg nga objekti.

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

Raporti i VNM-së dhe i Masave Zbutëse për Fazat e ndryshme të projektit si më sipër, synon fillimisht të identifikojë burimet, receptorët dhe pasojat negative dhe rreziqet e mundshme gjatë fazes së shfrytëzimit dhe mbylljes së gurores dhe nyjes së fraksionimit të inerteve.

Pasojat dhe/ose ndikimet mund të jenë gjeofizike, biologjike, socio-ekonomike dhe cënim i shëndetit të njeriut. Rreziqet kryesore kanë të bëjnë kryesisht me operimin e gurores dhe nyjes së fraksionimit të inerteve. Pas identifikimit të burimeve të ndikimeve dhe pasojave, do të kryet edhe vlerësimi i pasojave të tyre mbi receptorët.

Ndikimet grupohen si me poshtë:

- Kimike-Fizike të cilat lidhen me ndikimet mbi burimeve natyrore si edhe proceset e degradimit fizik të mjedisit.
- Biologjike-Ekologjike përfshirë burimet e energjive të rinovueshme, ruajtjen e biodiversitetit, ndikimin mbi jetën e gjallë të ndotjes së biosferës.
- Sociologjike të lidhura me komunitetin apo edhe individët e vacantë, ndikimin mbi trashëgiminë kulturore dhe progresin e supozuar.
- Ekonomike-Makroekonomike të cilat marrin parasysh ndikimet e përkohshme apo të përhershme shkaktuar për shkak të realizimit të projektit.

Ndikimi në cilësinë e tokës

Përsa i përket ndotjes së tokës ajo në aktivitetin e zhvillimit të gurores dhe në Linjën e prodhimit të inerte mund të jetë aksidentale nga derdhja e karburanteve që përdorin makinat dhe mjetet e gërmimit.

Germimi i tokës nuk do të ndotë ambjentin sepse nuk çlirohet asnjë lloj gazi thjeshtë do të ketë ndryshim në prishjen e strukturës natyrale të tokës në këtë sipërfaqe.

Ndikimet më të mundshme mbi tokën kanë lidhje me :

- Karakteristikat e tokës
- Morfologjia e tokës
- Ndotje

Nga punimet e shfrytëzimit rritet shkalla e prezencës së erozionit. Kjo vërehet më e lartë gjatë përdorimit të mjeteve pneumatike. Gjatë periudhës së shfrytëzimit në objekt është ndjekur një rradhë dhe drejtim i tillë i shfrytëzimit, që në kombinim me masat e tjera suplementare parandalojnë erozionin, shembjen dhe rëshqitjen e sipërfaqes së tokës rreth saj.

Për shmangien dhe parandalimin e erozionit, shembjes së sipërfaqes dhe rrëshqitjeve të ndryshme, në projekt është përcaktuar shfrytëzimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë i zonës në tërësi dhe daljeve të ndryshme të mineralizimit në veçanti për ç'do objekt.

Humbje e pjerësisë së tokës.

Humbja e pjerësisë së tokës nga shfrytëzimi do të jete e konsiderueshme sepse aktiviteti i shfrytëzimit me karrierë prek përkohësisht peizazhin ekzistues dhe topografinë e saj për gjatë kryerjes së aktivitetit .

Me masat që do merren për rehabilitimin e saj, gjelbërimin me bimë që rriten në zonë, gjatë shfrytëzimit dhe në mbyllje të aktivitetit , peizazhi dhe topografia e zonës do të përmirësohet dukshëm, do të krijohet një ambient panoramik i këndshëm për syrin e njeriut dhe çlodhës.

Dëmtimi i vegjetacionit bimor, sidomos gjatë hapjes së karrierës dhe shfrytëzimit të shkallës së parë dhe të dytë është faktor negativ.

Ndotja e tokës nga rrjedhjet.

Objekti është në fazë funksionimi dhe gjatë veprimtarisë së saj niveli i elementëve që transmetohen nga rreshjet e shiut është në nivel të moderuar. Ky fenomen bëhet aktiv në rastet kur në qiell të hapur ndodhen pjesë mekanike të automjeteve apo ambalazhe të vajrave lubrifikant apo grasove këto shpëlahen nga reshjet e shiut duke u shkarkuar në tokë.

Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta.

Sasia e sterileve do të depozitohet në sipërfaqen e caktuar për këtë qëllim. Ato përfaqësohen nga masa të shkrifëta, që nuk përmbajnë elemente ndotës për mjedisin. Këto depozitime janë pjellore dhe do të shërbejnë më së miri për tu përdorur si material për mbushjen e hapësirave të shfrytëzuara ose për rehabilitim të territoreve të gërmuara.

Ndotja e tokës nga depozitimi i llumrave.

Gjatë shfrytëzimit të objektit parashikohet depozitime llumrash që mund të kenë ndikim mbi ujërat e rrjedhshëm. Ky fenomen haset gjatë prezencës së shirave të cilët shpëllajnë materialin e nxjerrë nga karriera por ky nuk konsiderohet ndotës për tokën pasi është element i nxjerrë nga toka në këtë vendndodhje.

Vlerësimi i erozionit të tokës duke marrë në konsideratë gjendjen ekzistuese të ekuilibrit të tokës ku ndër elementët më të rëndësishëm mund të përmendim teksturën e tokës, aftësinë e infiltrimit (karakteristikat e shkëmbit), pjerrësia, përmbajtja e gurëve dhe faktorëve klimatik.

Mendohet se ekuilibri aktual i tokës do të priset në mënyrë rrënjësore gjatë zbatimit të projektit, duke rritur sidomos aktivitetin aerodinamik të shkaktuar nga era mbi materialin e imët të grumbulluar në sheshin e poshtëm dhe mbi atë të mbetur në vend gjatë gërmimeve.

Sidoqoftë në këtë projekt parashikohen masat zbutëse dhe planet e rehabilitimit që synojnë direkt eliminimin e plotë të erozionit eolik dhe rifitimit të një gjendje më të mirë se ajo fillestare.

Në formë tabelare ndikimin e aktivitetit në tokë e kemi si më poshtë

Lloji i ndikimit	Niveli i ndikimit		
	I ulët	mesatar	I lartë
Humbja e pjerrësisë së tokës			
Humbja e vegjetacionit të tokës			
Propabiliteti për praninë e fenomenit të erozionit			
Ndotja e tokës nga shpëlarja e mbetjeve nga rreshjet e shiut			

Ndikimi në cilësinë e ujrave
Ujërat Sipërfaqësore

Objekti ndodhet në Komunën Lukovë, por i ndodhur ngjitur me qytetin e Sarandës, në kufirin që ndanë Bashkinë Sarandë me Komunën Lukovë, në afërsi ka dhe detin Jon, por për tu ndikuar nga ndotja e ujërave sipërfaqësore është shumë larg.

Procesi i zbatimit të projektit nuk lë shkas për ndotje të ujërave rrjedhëse sipërfaqësore qoftë edhe indirekt (në tokë e më pas të shpëlahen nga rreshjet) nga karburantet, lëndët helmuese etj pasi ato nuk do të përdoren gjatë zbatimit të projektit apo rehabilitimit të territorit, ndërsa nga karburantet mund të ketë vetëm ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve të punës.

Ujërat nëntokësor

Zbatimi i projektit mund të ketë efekt disi në krijimin e zgavrave të mëtejshme të të çarave të shkëmbit nga rritja e sasisë dhe intensitetit të përshkrimit të shkëmbit nga ujërat sipërfaqësore ose rreshjet për shkak të reduktimit të materialit të gjelbër që mbulon vende-vende territorin duke rritur kështu kapacitetin.

Nuk do të ketë ndotje nga lëndët helmuese apo karburante (si në rastin e ujërave sipërfaqësore). Ndonese ndikimi do të jetë i vogël ai do të merret në konsideratë gjatë procesit të rehabilitimit.

Në procesin për fraksionim të gurit gëlqeror përveç mjeteve pneumatike përdoret makineri si mulliri për bluarjen e materialit dhe makineri të tjera . Ky është një ndikim i rastisur po ajo që vlen për tu përmendur është se nuk ndikohet cilësia e këtyre ujërave.

Në formë tabelare ndikimin e aktivitetit në cilësinë e ujërave e kemi si më poshtë:

Lloji i ndikimit	Niveli i ndikimit			
	I papërfillshëm	I ulët	mesatar	I lartë
Shpëlarja e terrenit nga ujërat e shiut të ndikojë në turbullirën e ujërave të detit				
Nxitja e erozionit nga rreshjet e shiut në objekt				
Ndotja e ujërave sipërfaqësore nga derdhjet aksidentale				

Ndikimet në florë dhe faunë

Impakti në florë

Në zonën e shfrytëzimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me status të veçantë. Flora dhe fauna lokale nuk do të preket nga shfrytëzimi, pasi sipërfaqja e objektit është pothuajse e zhveshur nga bimësia.

Sidoqoftë masat mjedisore që do të zbatohen në vijim të shfrytëzimit do të evitojnë ndikimet në mjediset përreth duke influencuar në reduktimin e ndikimeve hapësinore në florën ekzistuese në shpatet përreth objektit Gurorë + Nyje për prodhim Inertesh. Barishtet do të jenë ato elemente që preken nga zhvillimi i projektit. Ndikimi real do të bjerë mbi dheun dhe shkëmbin sipërfaqësorë, dmth dëmtimi radikal i habitat të florës dhe direkt mbi vegjetacionin duke e larguar plotësisht atë nga territori që do të shfrytëzohet.

Masat zbutese gjatë projektit dhe planit të rehabilitimit do të mbulojnë plotësisht humbjet në florë e vegjetacion madje në një kohë relativisht të shkurtër, pas

përfundimit të shfrytëzimit vejetacioni i zonës do të jetë në gjendje më të mirë nga ai fillestar.

Impakti ne Faunë

Fauna do te ndikohet nga:

- Punimet të cila gjenerojnë zhurmë si, përdorimi i mjeteve pneumatike dhe përdorimi i makinerive që përdoren për fraksionimin e gurit gëlqeror.

Pas mbarimit të shfrytëzimit do të përshtatet flora dhe fauna ku do të gjejë kushte të përshtateshme folezimit dhe shtimin e tyre fizik.

Ndikimet negative mbi faunën do të jenë të ndryshme, mbi klasa të ndryshme të saj. Po ti referohemi pasurisë së zonës në faunë del se klasa që ka ndikim të rëndësishëm është ajo e zvarranikëve, por specie që do të preken janë të pa rëndësishme dhe nuk figurojnë ndër ato të rrezikuara, të mbrojtura, endemike apo të kërcënuara. Një ndikim të pa rëndësishëm do të ketë gjatë shfrytëzimit të zonës, me shpend që pushojnë ose gjuajnë në këtë territor.

Planet e rehabilitimit do të influencojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës së faunës në krahasim me gjendjen para projektit, duke përmirësuar gjendjen e habitateve ashtu edhe koridoret për afrimin e faunës. Vetë natyra e klasave që preken bën që rehabilitimi i tyre të realizohet në një kohë mjaft të shpejtë dhe të rritet në një mënyrë të ndjeshme larmia biologjike e gjithë zonës.

Ndryshimet në ekosistem. Nuk pritet ndryshim i ekosistemit pasi kompania është dhe do të tregohet mjaft e kujdeseshme në zbatimin e teknologjive dhe metodave për nxjerrjen e gurit gëlqeror si dhe do të jetë e gatëshme të zbatojë të gjitha masat që do t'i rekomandohen për uljen e ndikimit gjatë fraksionimit të gurit gëlqerorë.

Në formë tabelare ndikimi i aktivitetit në florën dhe faunën është si më poshtë

Lloji i ndikimit	Niveli i ndikimit			
	I papërfillshëm	I ulët	mesatar	I lartë
Largimi i florës autoktone				
Derdhja e karburanteve nga automjetet e punës në mënyrë aksidentale në tokë				
Ndryshim i habitatit nga implementimi i kësaj veprimtarie				
Ndryshim i bimësisë në zonën e shfrytëzimit në mbyllje të objektit				

Ndikimet në cilësinë e ajrit

Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, LGP, PM10, NO₂, Pb, O₃, CO dhe BTEX të përzgjedhura qëllimisht në zonat urbane më të rënduara, përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të reflektuara edhe në VKM nr 803, datë 4.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit". Më poshtë po japim normat Shqiptare për këto indikatorë, sipas VNM –së së mësipërme

- NO₂ - bioksid azoti 60 mg/m³ (mesatare vjetore)
- SO₂ - bioksid squfuri 60 mg/m³ (mesatare vjetore)
- LGP - lëndë e grimtuar pezull 140 mg/m³ (mesatare vjetore)
- PM10 - lëndë e grimtuar < 10 mikrometër 60 mg/m³ (mesatare vjetore)
- O₃ - ozoni 65 mg/m³ (mesatare vjetore)
- Pb - plumbi 1 mg/m³ (mesatare vjetore)
- CO - monoksid karboni 2 mg/m³ (mesatare 24 orëshe)
- Benzeni (C₆H₆) 5 mg/m³ (mesatare 8 orëshe)

Burimet e ndotjes së ajrit vijnë nga:

- Gërmimet
- Përdorimi i mjeteve pneumatike
- Transporti i sterilit në vend depozitim ose në objektin e përdorimit
- Vend depozitimi i sterilit
- Djegia e lëndës djegëse nga puna e automjeteve të punës

Në objekt do të kemi nivel të lartë emetimesh gazoze dhe grimca që vijnë nga djegja e karburanteve të mjeteve të rënda si dhe materiale grimcore (pluhura) që vijnë kryesisht nga punimet gërmime / mbushje dhe transporti (materiale, punonjës).

Ndikimi më i madh, mund të jetë në sheshin e gërmimit, dhe nga aktivitetet ngarkim/ transportuese të mineralit/sterilit përgjatë rrugëve kombëtare për t'u dërguar ne destinacion sipas porosive.

Niveli më i lartë i emetimeve do të shkaktohet nga gazërat si rezultat i djegjes në mjetet e transportit. Veçanërisht problemi do të bëhet shqetësues në punimet e karrieres për shkak të natyrës së shfrytëzimit në qiell të hapur.

Agjentët atmosferikë si era mund të ngrenë sasi të konsiderueshme pluhuri nga kantieret e minierave prandaj në mot të thatë dhe me re nevojitet të lagen sipërfaqet e dampave si dhe materiali i depozituar aty. Mënjanimi i pluhurave do të realizohet nëpërmjet spërkatjes së vendit të punës me ujë.

Në formë tabelare ndikimi i aktivitetit në cilësinë e ajrit është si më poshtë

Lloji i ndikimit	Niveli i ndikimit			
	I papërfillshëm	I ulët	mesatar	I lartë
Cilësia e ajrit nga emetimi i tymrave nga djegja e lëndës djegëse nga puna e automjeteve të punës				
Transporti i sterilit në vend depozitim ose ne vendpërdorim pa prezencën e erës				
Transporti i sterilit në vend depozitim ose në vend perdorim me prezencën e erës				
Përdorimi i mjeteve pneumatike për nxjerrjen e gurit gëlqeror				
Përdorimi i makinerive si mullijtë e blojës që emeton pluhur				

Zhurmat dhe vibrimet

Burimet kryesore të gjenerimit të zhurmave dhe vibrimeve janë:

- Përdorimi i mjeteve në linjën për prodhimin dhe fraksionimin e inerteve.
- Përdorimi i mjeteve pneumatike
- Ngarkimi dhe shkarkimi i kamjonëve me steril

Duke u njohur me llojin e veprimtarisë kuptojmë se emetimi i zhurmave dhe vibrimeve në terren është i pranishëm.

Përdorimi i mjeteve pneumatike është burimi kryesor për gjenerimin e vibrimeve në zonë.

Zhurmat dhe vibrimet hasen gjatë përdorimit të mjeteve pneumatike të cilat nga fuqia dhe forca e madhe goditëse e gjenerojnë këtë ndikim.

Përdorimi i mjeteve për fraksionimin e inerteve si mullinjtë për bluarjen e inerteve dhe fraksionimin e tyre shkakton zhurma.

Zhurma gjenerohen dhe nga mjetet e transportit duke ditur që këto mjete janë të tonazheve të rënda dhe për rrjedhojë kur levizin si në objekt edhe në rrugë në qëndrat e banuara për transportimin e gurit gëlqerorë në objekt e sterilet e fraksionuara për në vendin e përdorimit gjenerojnë zhurma.

Në formë tabelare ndikimi i zhurmave dhe vibrimeve është si më poshtë

Lloji i ndikimit	Niveli i ndikimit			
	I papërfillshëm	I ulët	mesatar	I lartë
Zhurmat që prekin banorët e zonës nga puna e automjeteve të transportit				
Niveli i zhurmave që prek punëtorët nga përdorimi i makinerive për fraksionimin e inerteve				
Përdorimi i mjeteve pneumatike Transmeton/ emeton zhurma dhe vibrime tek banorët				
Përdorimi i mjeteve pneumatike gjeneron zhurma dhe vibrime që prekin punonjësit.				
Ngarkimi dhe shkarkimi i sterilit në kamjon				

Mbetjet e ngurta

Me një menaxhim të kujdesshëm të mbetjeve të ditës mund të bëhet i mundur eliminimi total i të gjitha mbetjeve. Në asnjë rast ato nuk do të lejohen të digjen por duhet të parashikohet që të ngjeshen e të ambalazhohen (përdoren thasët e boshatisur të çimentos) dhe të bëhet largimi i tyre sa më i shpejtë për në vendet e paracaktuara.

Në rastin e mbetjeve organike të terrenit dhe të vegjetacionit (priten shkurre, heqje vegjetacioni) mund të bëhet eliminimi i tyre direkt ne vend. Për këtë qëllim rekomandohet që copëtimi dhe varrosja e tyre te behet direkt ne territoret përreth (brënda pronës). Hedhjet dhe grumbullimet në pronat ngjitur apo në vënde përreth kantierit nuk duhet të ndodhin. Ndalohet rreptësisht edhe djegia e tyre.

Inkurajimi i përdorimit të produkteve më miqësore ndaj mjedisit dhe teknikave më të mira të disponueshme

Nga ana e përmbajtjes granulometrike guri gëlqeror është miqësor me mjedisin pasi është element natyror i këtij vendburimi. Ky produkt steril kthehet në produkt armiqësor me mjedisin ne qoftë se sistemimi i tij nuk bëhet në varësi të parametrave fiziko-mekanik te argjilave të shkrifta . Prandaj këndi i shpateve të sterileve në shkallë dhe në sheshe do të jetë më i vogël se këndi i fërkimit të brendeshëm, në kete rast nuk do t'i kalojë 30° (ose më saktë këndi i shpatit të mbushjes do të jetë i barabartë me këndin e relievit se për ndryshe do të kemi fenomenin e rrëshqitjes së shpateve në sheshin e sistemimit të sterileve dhe në shkallët e karrierës.

Ndikimet social-ekonomike

Punimet në objekt ndikojnë edhe në drejtim të mjedisit human. Ku ndikimi është shumë palësh.

Ai mund të jetë i drejtpërdrejtë ose indirekt, sikurse mund të jetë si negativ ashtu edhe pozitiv.

Ndikimi indirekt përfshin disa aspekte të aktivitetit ekonomik ku përdoren gjerësisht materialet e prodhuara nga këto aktivitete .

Më poshtë po renditim aspektet pozitive dhe negative të ndikimit në mjedisin human të punimeve të hapjes, shfrytëzimit dhe rehabilitimit të gurores dhe linjës për prodhim Inerte .

Ndikimet pozitive

Punësimi: Zona ku ndodhet aktiviteti i subjektit "Inertobeton" sh.p.k., gurore + linjë prodhimi inertesh, ka shkallë të lartë papunësie, shkaqet e së cilës janë pothuajse të njëjta me ato të gjithë vendit tonë këto vitet e fundit. Kështu që këto aktivitete po ndikojnë sado pak në zbutjen e këtij fenomeni. Janë të punësuar inxhinier, teknik, shofera, manovratorë, punonjës të thjeshtë që merren me punë të ndryshme në këto aktivitete.

Aspekti negative

Pas perfundimit të shfrytëzimit të karrierës së gurit gëlqeror dhe punës në linjën e fraksionimit të inerteve do të duhen shpenzime suplementare për të rehabilituar jo vetëm sheshin e gurores dhe rrethinat e saj por edhe sipërfaqet e rrugëve brenda objektit. Kjo do të ndikojë në koston e konomike të subjektit , por më me hollësi këto do të trajtohen në kapitullin e rehabilitimit.

Matrica e ndikimeve më të rëndësishme (pozitive dhe negative)

Meqënëse aktivitetet të cilat ne studiojmë gurore + linjë prodhim inertesh , janë në faze funksionimi edhe analiza e ndikimeve si pozitive edhe negative , bëhet në këtë faze si dhe në atë të mbylljes. Duke qenë se këto aktivitete ndodhen në të njëjtin territor dhe janë të lidhura ndërmjet tyre do të kemi vetëm një matricë të ndikimeve.

Ndikimi	Gjatë shfrytëzimit	Pas mbylljes
Cilësia e Ajri		
Toka		
Ujrat sipërfaqësore		
Ujrat nëntokësor		
Zhurmat		
Fauna		
Flora		
Infrastruktura/Trafiku		

Peisazhi		
Social-ekonomik		
Shëndeti publik		

Shpjegues:

	Ndikim pozitiv
	Ndikim negativ
	Ndikim i vogël pozitiv

PLANI I REHABILITIMIT

Synimet e planit të rehabilitimit

Plan i rehabilitimit synon që pasi të përfundojë zbatimin e tij, subjekti të ketë realizuar këto detyrime:

- Të ketë realizuar stabilizimin fizik (regjimin ujor, sterilet, erozionin, masat e sigurisë publike) të sipërfaqes së karrierës
- Të ketë realizuar punimet biologjike
- Të minimizojë ndikimin pamor të zonave të degraduara e të përmirësojë pejsazhin
- Të mundësojnë në fazat e më vonëshme të maturimit të procesit të rehabilitimit në përdorimin e sipërfaqes së karrierës

Masat rehabilituese

Rehabilitimi i sipërfaqes së karrierës është kryer hap pas hapi, gjatë ecurisë së karrierës dhe konsiston në :

- Punimet e sistemit të dherave dhe mbeturinave pluhurore që do të krijohen nga fraksionimi dhe shfrytëzimi i gurit gëlqeror
- Punimet e maturimit të shtratimit të dheut
- Mbjellja e fidanëve dhe bimësisë shkurre
- Marrja e Masave për mbrojtjen e mjedisit

Sipërfaqja horizontale e sheshit të karrierës që do të rehabilitohet deri në mbyllje të karrierës është **4 ha**

Sipërfaqja e tarracave tek shkallët e karrierës që do të rehabilitohet është **26 300 m²**

Punimet e sistemimit të dherave dhe mbeturinave pluhurore që do të krijohen nga fraksionimi dhe shfrytëzimi i gurit gëlqeror

Subjekti ka marrë një sërë masash për sistemimin e mbetjeve që krijohen nga shfrytëzimi i gurit gëlqeror si dhe nga fraksionimi i tij .

Masa e dheut që është gjeneruar është sistemuar në mënyrë të atillë që një pjesë të përdoret për të mbuluar sheshin e krijuar nga shfrytëzimi i gëlqerorëve dhe pjesa tjetër në shkallët mbrojtëse të krijuara në objekt . Dheu që është përdorur në formimin e sipërfaqes së krijuar nga shfrytëzimi është sistemuar dhe ngjeshur .

Subjekti ka ruajtur copra të përmasave të ndryshme të shkëmbinjëve me qëllim që t'i përdorë për të realizuar shtratimin strukturor në shkallët mbrojtëse ku do të hidhet dheu. Këto copëra gurësh janë hedhur nëpër breza mbrojtës në mënyrë të tillë që të stabilizojnë masën e dheut që është hedhur dhe do të hidhet dhe të ruajë atë nga efektet e agjentëve atmosferik gërryes dhe shpëlarës.

Gjithashtu në objekt janë ndërtuar rreth **1600 m³ mure mbajtëse**, të cilat i kanë dhënë mundësinë e sistemimit të dherave dhe materialeve mbeturinë , duke krijuar sheshe dhe tarracime të ambientit . Po kështu janë realizuar rreth **4000 m³ mbushje për nivelimin e ambientit** , të cilat janë përgatitur për mbjellje nga subjekti.

Punimet e maturimit të shtratimit të dheut

Para se të realizohet mbjellja e shtratimit të dheut me llojin që do të zgjidhet nga subjekti në bashkëpunim me specialistët kryesisht të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor në rreth, është e nevojshme që shtratimi i dheut të maturohet në mënyrë të tillë që te ofroj kushte të përshtatëshme për mbirjen e farërave dhe rritjen e fidanëve. Gjatë kësaj kohe masa e dheut do të plehërohet me pleh organik dhe do të punohet me bel. Në përfundim bëhet testimi i shtratimit të dheut për filtrimin e ujit , strukturën e ajrosjes, stabilitetin strukturor, fizik, aftësinë ujëmbajtëse dhe pastaj do të përgatitet për mbiellje.

Realizimi i mbjelljes së "tapetit të gjelbër" në shkallët mbrojtëse

Ky operacion do të kryet menjëherë pas testimit që i është bërë sheshit në linjën e prodhimit të inerteve dhe në hapësirën e krijuar nga shfrytëzimi. Pas ngjeshjes, nivelimit, dhe hapjes së kanaleve kullues drenazhues sipërfaqja e sheshit të brezit mbrojtës do të shkrifërohet me krehër dhe do të mbillet me farë bari (**lilolium**) ose farë bari nga bimët barishtore të zones si lloj (**trifolium**). Kjo bimësi duke qenë me sistem rrënjor xhufkorë do të luajë rolin e stabilizuesit biologjik të masës së dheut në fazën e parë të riaftësimit të tokës dhe fillimin e zhvillimit të proceseve fillestare të formimit të strukturës së tokës dhe raportet ajër-ujë të agregateve toksësore dhe poreve.

Në këtë fazë mund të kryhet dhe mulçinim modest i sipërfaqes së mbjellë me një shtresë të hollë plehu organik dhe mbulesës vegjetale.

Si rezultat i punimeve të krijuara nga subjekti si gjermim, mure mbajtëse, mbushje me dhe' është krijuar një sipërfaqe rreth **3000 m²**, në të cilën janë mbjellë fidanë të ndryshëm.

Mbjellja e fidanëve dhe bimësisë shkurre

Ky operacion do të bëhet pas një periudhe kohe të caktuar . Kjo për arsye që masa e dheut të sistemuar mbi masën e brezave të jetë stabilizuar dhe të ketë fituar cilësitë e nevojshme për zhvillimin e bimësisë shkurre dhe fidanëve . Mbjellja e bimësisë autoktone në sipërfaqen e shtruar më parë do të bëjë të mundur **stabilizimin e zonës së shfrytëzuar, mbrojtjen nga erozioni, si dhe rregullimin e pejsazhit të zonës.**

Në këtë karrierë është menduar të mbillen bimë autoktone të cilat kanë përparësi pasi e kanë më të lehtë të përshtaten. Pemët që do të përdoren në zonë do të jenë në rradhë të parë ullinj. Në tërësi do të mbillen ato pemë që shumëzohen me anë të farës, ndaj mbjellja do të bëhet me fidanë të trajtuara më parë në fidanishte për një periudhë katër vjeçare.

Nga ana e subjektit janë mbjellë rreth 200 rrënjë ullinj dhe agrume . Deri sa fidanët e mbjellë të arrijnë madhësinë normale dhe për të mos lejuar zhvillimin e erozionit , të gjitha pjesët anësore të skarpateve të krijuara janë mbjellë me vresht.

Masat për mbrojtjen e mjedisit

Masat për mbrojtjen e mjedisit që janë marrë dhe do të mirren në vazhdimësi nga ana e Shoqërisë janë:

- Territori i kantierit të sistemohet dhe të gjelbërohet me vegjitacion të lartë i cili të jetë i përshtatshëm për kushtet fitoklimatike të zones
- Të bëhet pastrimi periodik i makinerive
- Të mirëmbahen kanalizimet e brendëshme të objektit
- Të merren masa për evitimin e pluhurave që mund të shkaktohen nga prodhimi i inerteve.
- Të merren masa për evitimin e erozionit
- Për zbutjen e ndikimit në mjedis të zbatohen normat ligjore, për shkarkimin në tokë, në ajër dhe në ujë
- Nga aktiviteti që ushtrohen të mos ketë ndikim tek njerëzit dhe në mjedis.
- Të kryehet monitorimi periodik i zhurmave dhe i shkarkimeve në ajër, ujë dhe të dhënat të dërgohen pranë Drejtorisë Rajonale të Mjedisit , Qarku Vlorë

Çdo 6-muaj të dërgohet informacion i hollësishëm mbi nivelin e punimeve të kryera pranë DRM-së, Qarku Vlorë

Për këtë arsye nga ana e subjektit janë marrë një sërë masash konkrete për të zbutur ndikimet negative në mjedis. Këto masa konsistojnë në uljen e ndotjeve në ajër si pluhurat dhe zhurmat, uljen e efekteve negative në florën dhe faunën e zonës.

Kryesore në këtë aktivitet është që me mbarimin e shfrytëzimit të karrierës, të ketë mbaruar edhe rehabilitimi i tokës dhe evitimi maksimalisht i erozionit.

Mbrojtja nga zhurmat realizohet duke përdorur pajisje dhe makineri të teknologjisë së fundit, të cilat janë të pajisura me sistem mbrojtës nga zhurmat si dhe pajisja e punonjësve me mjete individuale kundër zhurmave.

Mbrojtja nga pluhurat është realizuar nëpërmjet pajisjeve për kapjen e pluhurave si në impiantin e fraksionimit të inerteve dhe në atë të shpimit me sondë në karrierën e gurit. Shpimi i birave me sondë bëhet duke përdorur ujin. Kurse në impiantin e prodhimit të inerteve përdoret edhe spërkatja me ujë, gjë që eliminon dhe shpërndarjen e pluhurit rreth ambientit. Punonjësit që janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me pluhurin , përdorin maska mbrojtëse ndaj pluhurit. Gjithashtu lagia herë pas here e ambienteve, stoqeve dhe ngarkesave të makinave për të

tretët, e cila mundëson krijimin e një cipe për mos lejimin e pjesëve eolike nga era, ndikon pozitivisht për mbrojtjen nga pluhurat.

Mbrojtja nga erozioni konsiston në :

- Sistemimin e skarpateve përfundimtare të shkallëve të karrierës duke respektuar drejtimin dhe profilin dinamik të shfrytëzimit.
- Gjeometrizimin e shesheve dhe skarpateve të shkallëve të karrierës
- Krijimin e kushteve të përshtatshme për mbjelljen dhe kultivimin e fidanëve të ndryshëm
- Sistemimi i ujërave dhe kanaleve anësore në rrugët e përherëshme dhe të përkohëshme
- Sheshet e shfrytëzimit , që konsiderohen të përfunduara janë niveluar me mbeturina inertesh dhe argjile, ku aplikohen mbjellje me fidanë dhe kanalizimi i ujërave të shiut , kryesisht për ditët me rreshje

Mbiellja me pemë është realizua në të gjitha fazat , në mënyrë graduale , që nga krijimi i kësaj karriere. Mbjellja e pemëve realizohet në të gjitha ambientet e kantierit , si anës rrugës, përreth sheshit të linjës së prodhimit të inerteve , objekteve të tjera dhe zyrave. Këto masa shërbejnë edhe për uljen e nivelit të pluhurit dhe të zhurmave jashtë zonës së shfrytëzimit

Subjekti "Inertobeton" sh.p.k. në planin e tij afatmesëm, pas mbylljes së karrierës së gurit gëlqeror, ka planifikuar që këtë ambient ta kthejë në një zonë turistike . Ky ambient do të kthehet në një zonë rekreative me vila dhe hotele , ambiente shlodhëse dhe fusha të ndryshme sportive, ku vilat e vendosura në pjesën lindore të objektit , do të jenë masive dhe të vazhduara dhe do të vendosen sipas terrenit, pikërisht në pjesën ku sot është gurorja.

Ky është një projekt ambicioz që do të prezantohet nga subjekti "Inertobeton", ku krahas objekteve rezidenciale dhe vilave të tipeve të ndryshme, mbizotëron sipërfaqja e gjelbëruar, basenet ujore (pishinat) fushat sportive dhe lodrat e ujit si edhe një marinë e vendosur në pjesën veriore të kufirit të kësaj prone , në det.

Realizimi i këtij projekti do të krijojë një rezidencë pushuese dhe çlodhëse , me ndikime mjaft pozitive si në mjedisin e përgjithshëm të zonës ashtu edhe në mjedisin human dhe social. Ndërtimi dhe funksionimi I kësaj rezidence do të sjellë një numur të madh pushuesish , të cilët do të rrisin të ardhurat e komunitetit rrethues të zonës, por që në momentin e ndërtimit ashtu edhe të funksionimit të tij do të ketë një numur të konsiderueshëm njerëzish të punësura, çka do të sjellë sado pak uljen e papunësisë të zonës përfaqë kësaj zone.

Bashkëngjitur një masterplan i zhvillimit të kësaj zone, i cili është në fazën e projekt – idesë.

PLANI I MONITORIMIT TË MJEDISIT

Për aktivitetet të cilat ne edhe po studiojmë, gurorë + linjë prodhimi inertesh, subjekti vetë duhet të kryej "vetëmonitorimin" duke bashkëpunuar me institucione të specializuara dhe të licensuara .

Duhet të kryhet programimi i monitorimit nga ndotja në këto parametra:

- Cilësia e ajrit dhe përmbajtja e pluhurave
- Riaftësimi i zonave të shfrytëzuara për të mos humbur vlerat fillestare gjeografike dhe gjeologjike
- Sistemimim i ujërave të bardha
- Ndërtimi dhe ruajtja e brezave të sigurisë
- Lagia në vazhdimësi e shesheve dhe rrugëve të brendshme të objektit , dhe kryesisht rrugën hyrëse deri në objekt.
- Të eliminohet derdhja e ujërave dhe karburanteve në sipërfaqen e tokës
- Gjatë transportit të materialeve të monitorohet lëvizja e mbuluar e materialeve
- Emetimi i gazrave dhe zhurmave të makinerive në ajër të kontrollohen një herë në vit.
- Mbështetur në rezultatet monitorimit , të hartohet plani i masave dhe fondet e nevojshme për eliminimin e ndotjeve dhe rigjenerimin e mjedisit

Gjatë përgatitjes së planit të monitorimit është menduar që vetë kompania të përzgjedhë subjektin që do të kryejë monitorimin, si edhe elementët që realisht mund të identifikohen, maten dhe regjistrohen.

Të dhënat që dalin nga monitorimi duhet të hidhen në një regjistër nga ana e kompanisë, të cilat të jenë të aksesueshme nga organet e administrimit dhe kontrollit të mjedisit (Drejtoria Rajonale e Mjedisit e Qarkut Vlorë dhe Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave) dhe të dorëzohen pranë këtyre organeve sa herë të jetë e nevojshme.

Disa nga indikatorët të cilat duhet të monitorohen për të vlerësuar situatën e gjendjes së mjedisit, si dhe për të marrë masat e duhura në raste të ndryshme po jepen më poshtë në formë tabelare.

Nr.	Elementët e monitorimit	Frekuenca
1.	Monitorimi i zhurmave tek mulliri i bluarjes dhe tek pajisjet e linjës së fraksionimit të inerteve	Në vazhdimësi
2.	Monitorimi i cilësisë së ajrit në gjithë objektin (gurore + linjë inertesh) si edhe në rrugë	Kryesisht gjatë stinës së thatë
3.	Monitorimi i gjendjes së mjeteve të mekanikës dhe mundësisë për ndonjë rrjedhje të mundshme	Në vazhdimësi
4.	Monitorimi i faktorëve që shkaktojnë rreziqe natyrore dhe humane	Në vazhdimësi
5.	Monitorimi i biodiversitetit në zonën rreth objektit të shfrytëzimit	Në vazhdimësi

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

Duke përfunduar raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe duke analizuar gjithë situatën e këtij aktiviteti arrijmë në konkluzionin se ky është një aktivitet që me masat që ka marrë dhe ato që do të marrë në vazhdimësi i vjen në ndihmë mbrojtjes së mjedisit.

- Procestet që kryen nga subjekti si ai i nxjerrjes së gurit gëlqeror edhe ai i prodhimit të inerteve nga linja e fraksionimit të gurit , nuk janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut , me masat e marra dhe ato që do të zbatohen në vazhdimësi nga subjekti.
- Prodhimi i materialeve të ndërtimit për nevojat e industrisë së ndërtimit dhe banesave është një domosdoshmëri
- Aktiviteti nuk ka ndikime në tokë dhe nuk ndikon në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore të zonës
- Nuk ndikon negativisht në cilësinë e ajrit të zonës , si dhe nuk shkakton çlirim në ajër të substancave kimike
- Nga zhvillimi i këtij aktiviteti janë hapur vende të reja pune, që ndikojnë sado pak në uljen e varfërisë për banorët në afërsi të zonës së projektit.
- Do të ndryshojë komplet zona pas mbylljes së këtij aktiviteti me zbatimin e projektit që do të zbatohet në vazhdimësi , duke shtuar sipërfaqet e gjelbëruara dhe ambientet rekreative.

Rekomandime

Kraha masave të marra në vazhdimësi nga ana e subjektit i cili ka rreth 20 vjet që e zhvillon këtë aktivitet, dhe për të perfeksionuar situatën në këtë objekt , nga ana jonë po japim disa rekomandime të cilat megjithëse mund të jenë të ditura prej subjektit , do t' i bëjmë me dije për zbatim në vazhdimësi të punës.

- Të merren masa për evitimin e pluhurave që mund të shkaktohen nga prodhimi i inerteve


- Të kryhet sprucimi periodik me ujë i sheshit të depozitimit të inerteve me qëllim minimizimin e grimcave të pluhurit (PM 10) në ajër kryesisht gjatë periudhës së thatë (në verë dhe pjesërisht në pranverë dhe vjeshtë)
- Të merren masa në vazhdimësi për evitimin e erozionit
- Të zbatohen normat ligjore për shkarkimet në tokë, në ajër dhe në ujë, për zbutjen e ndikimeve në mjedis
- Të instalohen agregatë teknologjik që parandalojnë ose zbusin ndikimin në mjedis
- Parkimi i mjeteve të transportit të bëhet vetëm brenda territorit të objektit
- Të merren masa për ruajtjen e karburanteve dhe lubrifikanteve që përdoren gjatë procesit të fraksionimit të inerteve ose për makineritë e transportit
- Të kontrollohen në vazhdimësi kushtet teknike të mjeteve , për të parandaluar rrjedhjen e karburanteve dhe lubrifikanteve në mjedis, si dhe emetimin e gazrave dhe të zhurmave që mund të shkatohen nga ndonjë avari teknike
- Territori i kantierit (gurore + linjë prodhimi inertesh) të sistemohet në vazhdimësi dhe periferia të mbillet me vegjetacion të lartë , të përshtashme me kushtet fitoklimatike të zonës
- Transporti i materialeve inerte të kryhet me mjetet të pastra (të pastrohen gomat e makinave kur dalin nga kantieri për në rrugë) si dhe gjatë transportit mjetet të mbulohen me mbulesa për të evituar rrjedhjen e materialit inert dhe për të evituar pluhurat.
- Të mirren masa për parandalimin e rënies së zjarreve nga plasje , shpime , energji elektrike, djegie aksidentale e depozitës së karburantit etj , si dhe të sigurohen mjetet e ndërhyrjes së shpejtë në rast zjarri (depozita uji , zjarrëfikëse të lëvizshme etj , sipas projektit të mbrojtjes kundra zjarrit)
- Në mjediset e objektit të vendosen kontenierë për grumbullimin e mbeturinave të krijuara , të cilat të evadohen në vendin e përcaktuar nga Komuna Lukovë.
- Të trajnohen të gjithë punonjësit para fillimit të punës me rregullat e sigurimit teknik , si dhe pas marrjes së lejes mjedisore të njihen me kushtet e kësaj lejeje.

- Të bëhet trajnimi periodik i punonjësve dhe në rast avarie në objekt, çdo punonjës ndërpret punën, fik makinerinë ku punon , lajmëron drejtuesit për avarinë dhe ndihmon për eliminimin e avarisë në objekt.
- Rehabilitimi i objektit të përfshijë të gjitha operacionet e punës dhe të realizohet paralelisht me shfrytëzimin e objektit

MATERIALI U PËRGATIT NGA:

SPECIALISTE MJEDISI

SULBENA BALILAJ



ING. SULBENA BALILAJ
V.N.M. E AUDITIM
MJEDISOR-EXSPERTË